

VENDIM
Nr. 2, datë 11.12.2017

PËR MIRATIMIN E LOGOS KOMBËTARE NË KUADËR TË “VITIT MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT”, SË BASHKU ME SHKRIMIN “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT-2018”

Në mbështetje të pikës 4 të vendimit nr. 494, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave për krijimin e Komisionit Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, Komisioni Shtetëror për organizimin e veprimtarive, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”,

VENDOSI:

1. Miratimin e logos kombëtare të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, e cila paraqitet si një yll me 36 rreze, prej të cilave 6 janë rreze kulmore, me ngjyre të kuqe gjaku, me shqiponjën dykrenore të stemës heraldike të Kastriotëve me ngjyrë të zezë në qendër, brendashkruar diçiturës “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT-2018”, me shkronja kapitale, sipas modelit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Logo shpaloet edhe në dy variante të tjera për t’ju përputhur qëllimeve sociale për të cilat mund të përdoret (modeli nr. 2 dhe nr. 3).

2. Logoja kombëtare e “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” përdoret në:

- Dekretet e Presidentit të Republikës;
- Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë;
- Aktet e Këshillit të Ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e Kryeministrit;
- Urdhrat dhe udhëzimet e ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kuvendit;
- Vendimet e institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e titullarëve të institucioneve të qeverisjes vendore;
- Urdhrat dhe udhëzimet e rektoratit të universiteteve;
- Dokumentet e krijuara nga autoritetet publike;
- Veprimtaritë e organizative jofitimprurëse, kur ato zhvillohen në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

3. Veprimtaritë, shfaqjet vizuale dhe botimet e ndërmarra nga ente private për qëllime fitimprurëse, nuk mund të përdorin logon veçse rast pas rasti, pas miratimit paraprak nga Komisioni Shtetëror të një kërkesë të justifikuar nga objektivi i këtyre veprimtarive, në përputhje me qëllimet e Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

4. Uzurpimi apo përdorimi abuziv i logos ndëshkohet sipas ligjeve përkatëse në fuqi.

5. Përmasat e logos në një letër format A4 janë: e lartë 27.5 mm; e gjerë 24 mm; shkrimi “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT-2018” vendoset rreth e qark shqiponjës, dhe është 34 mm i lartë; e 34 mm i gjerë sipas modelit nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Sipas përdorimit mund të ndryshojë ngjyra, përkatësisht (fusha e kuqe-shqiponja e bardhë-shkrimi “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT-2018” me shkronja kapitale) dhe (fusha e bardhë-shqiponja e kuqe-shkrimi “VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT” në anë të djathtë të saj).

6. Logoja të përdoret në posterat dhe ftesat e veprimtarive të rëndësishme shtetërore dhe ndërshtetërore, që do të zhvillohen në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”.

7. Logoja të përdoret si imazh bazë për konceptimin e shenjave kremtuese, për mirënjohje apo përkujtimore të të gjitha përmasave dhe llojeve, të cilat mund të shërbejnë si elemente dalluese gjatë ceremonive të ndryshme zyrtare, shtetërore dhe ndërshtetërore.

8. Logoja nuk zëvendëson në asnjë rast stemën e Republikës, por përdoret së bashku me të. Logoja, ashtu si dhe stema e Republikës, vendoset në të gjitha aktet zyrtare të sipërpërmendura gjatë gjithë vitit 2018.

9. Logoja, kur paraqitet e shoqëruar me stema shtetesh të tjera, vendoset në një vend të dukshëm, së bashku me stemën e Republikës ose në të njëjtin vend me to.

10. Ngarkohen anëtarët e sekretariatit teknik për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe Këshilli i Lartë i Arkivave për të përfshirë logon në modelet e shkresave zyrtare, duke miratuar ndryshimet përkatëse në vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në

autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT SHTETËROR
Edi Rama
KRYEMINISTËR

